



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 13 regjistër (JR)  
Datë 24.02.2022

Nr. 13 i vendimit  
Datë 16.05.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 16.05.2022, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonçi Petković, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 13/2022 (JR), datë 24.02.2022, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Petrit Bica, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga avokat Klodjan Skënderaj, me numër licence 3023.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 5, 35, 42, 48, 52, 122, 148 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet F dhe G të Aneksit të Kushtetutës; nenet 1, 6, 7, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 442-471 të Kodit të Procedurës Civile; nenet 1-21, 95, 108-114 dhe 128-133 të Kodit të Procedurave Administrative; neni 4, pika 6 dhe 62-64 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 27, pika

1, 1/2 dhe 3, si dhe neni 64, pika 1, shkronja “c” dhe pika 5 e ligjit nr. 92/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; si dhe nenet 44, 46, 48 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

### **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe dëgjoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit Petrit Bica dhe avokatit të tij Klodjan Skënderaj, të cilët kërkuan ndryshimin e vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Steven Kessler,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Petrit Bica, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ishte prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka filluar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, duke caktuar me short trupin gjykues. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.12.2019, trupi gjykues i Komisionit ka vendosur, ndër të tjera, fillimin e hetimit administrativ mbi procedurën e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Bica.
3. Subjekti i rivlerësimit, më datë 01.12.2021, i ka paraqitur Këshillit të Lartë të Prokurorisë kërkesën e regjistruar në këtë të fundit me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021, “Për miratimin e pensionit të parakohshëm”.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, ka vendosur miratimin e pensionit të parakohshëm për z. Petrit Bica, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si dhe mbarimin e statusit të magjistratit më datë 31.01.2022.

5. Në këto rrethana, Komisioni, me vendimin nr. 506, datë 31.01.2022, ka deklaruar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petrit Bica, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

6. Komisioni, me vendimin nr. 506, datë 31.01.2022, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet 64 e 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi:
  1. *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petrit Bica, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
  2. *Ndalimin e emërimit të z. Petrit Bica si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare [...].*

## **III. Shkaqet e ankimit**

7. Kundër vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Petrit Bica (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), duke kërkuar ndryshimin, saktësimin e pjesës arsyetuese dhe ndryshimin e dispozitivit të vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si në vijim: *Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Petrit Bica, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.*
8. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar pjesën përshkruese/arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, të Komisionit, si një arsyetim i gabuar, joobjektiv, i papranueshëm, i pavërtetë, i pambështetur në prova dhe në ligj, duke parashtruar shkaqet e ankimit, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

**8.1** Komisioni abuzon, paraqet të dhëna të rreme, nuk është objektiv në raport me të vërtetën dhe aktet e administruara.

**8.2** Arsyetimi dhe dispozitivi i Komisionit, bazuar në parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është i papranueshëm dhe joligjor, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kërkesë për dorëheqje përpara KLP-së, por ka ushtruar të drejtën për të dalë në pension, në bazë të nenit 52 të Kushtetutës, ka respektuar të drejtën e pakufizuar, të njohur nga ligji për të dalë në pension të parakohshëm, për rrjedhojë vendimi i Komisionit ka shkelur parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, dhe ka bërë që subjekti i rivlerësimit të penalizohet pa ligj, në shkelje të parimit universal të ligjshmërisë, duke rënë ndesh me Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

9. Subjekti i rivlerësimit, në funksion të pretendimeve të tij, bashkëlidhur ankimit ka paraqitur disa akte shkresore<sup>1</sup>.

#### IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Petrit Bica dhe për të cilin ai, nëpërmjet ankimit, kërkon ndryshimin e pikës 2 të tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>2</sup>, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit, ka paraqitur aktet shkresore si vijojnë.

- Vendimi nr. 506, datë 31.01.2022, i panëshkruar nga trupi gjykues i Komisionit, i cili në faqen 2, paragrafi 7, mban emrin B. M.

- Vendimi nr. 506, datë 31.01.2022, i panëshkruar nga trupi gjykues i Komisionit, i cili në faqen 2, paragrafi 7, mban emrin Petrit Bica.

- Vendimi nr. 506, datë 31.01.2022, i nënshkruar nga trupi gjykues i Komisionit me nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2022.

- Kërkesë nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021, "Për miratimin e pensionit të parakohshëm", drejtuar KLP-së, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

- Memo e datës 10.01.2022, drejtuar KLP-së lidhur me kërkesën e datës 01.12.2021 "Për miratimin e pensionit të parakohshëm", nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

- Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror, të z. Petrit Bica".

<sup>2</sup> Komisioni, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2022, i ka njoftuar subjektin të rivlerësimit, vendimin nr. 506, datë 31.01.2022, dorëzuar në zyrën postare më datë 03.02.2022 dhe marrë njoftimi nga subjekti i rivlerësimit Petrit Bica, më datë 09.02.2022, sipas të dhënave të lajmërimarrjes së zyrës postare. Subjekti i rivlerësimit, më datë 15.02.2022, ka paraqitur ankimin pranë Komisionit, ankim i regjistruar me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.02.2022.

b) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 506, datë 31.01.2022, u mor fillimisht në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në dhomë këshillimi, në seancën gjyqësore të datës 13.04.2022.
13. Trupi gjykues, në verifikim të kërkesave të nenit të sipërcituar në raport me shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, edhe pse ai nuk kishte kërkuar shprehimisht që Kolegji të shqyrtojë çështjen e tij në seancë gjyqësore publike, konstatoi si vijon.
- Komisioni, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.12.2019, ka vendosur fillimin e hetimit administrativ për procedurën e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Bica. Me qëllim vlerësimit të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme që lidheshin me procesin e rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, me *e-mail*-in e datës 15.01.2020, Komisioni i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit trupin gjykues, si dhe i ka kërkuar që brenda 20 ditëve të jepte përgjigje dhe informacion të plotë për pyetjet e dërguara bashkëlidhur *e-mail*-it.
- Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike me *e-mail*-in e datës 02.12.2021, ka njoftuar Komisionin se ka paraqitur pranë KLP-së, kërkesën e regjistruar në këtë të fundit me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021, “Për miratimin e pensionit të parakohshëm”.
- KLP-ja, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, ka vendosur miratimin e pensionit të parakohshëm për z. Petrit Bica, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe mbarimin e statusit të magjistratit më datë 31.01.2022.
- Nëpërmjet postës elektronike, me *e-mail*-in e datës 19.02.2022 drejtuar Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është njohur me vendimin e sipërcituar të KLP-së dhe ka konfirmuar se këtë vendim nuk do ta ankimojë<sup>3</sup>. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se: *[...] konfirmoj me vullnetin tim të lirë dhe të pavesuar, mbarimin e statusit të magjistratit dhe se nuk do të paraqitem në seancë dëgjimore, pasi pas datës 31.01.2022, nuk gëzoj më statusin e magjistratit (prokurorit) sipas ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar dhe vlerësoj se nuk jam më subjekt i ligjit nr. 84/2016.*
- Në vendim, Komisioni ka argumentuar mungesën e zhvillimit të seancës dëgjimore publike, mbështetur në konfirmimin e sipërcituar të subjektit të rivlerësimit për të mos ushtruar të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

<sup>3</sup> Në ankim dhe gjatë gjykimin në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk ka referuar se ka ushtruar ankim ndaj vendimit të KLP-së nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022.

<sup>4</sup> Paragrafi 8 i vendimit të Komisionit.

14. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni e të përcjella në Kolegj për efekt të shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupit gjykues nuk i rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë i qartë lidhur me efektet që ka pasqjellë në ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar, mbarimi i statusit të magjistratit për shkak të daljes së tij në pension të parakohshëm pleqërie, në mënyrë të veçantë lidhur me pasojën e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit dhe zbatimit të ndalimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
15. Për sa më sipër, për të garantuar të drejtat procedurale të subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në mënyrë efektive përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, lidhur me të gjitha pretendimet e tij mbi procesin e rivlerësimit, si dhe për zgjidhjen sa më të drejtë të kësaj çështjeje, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, në seancën gjyqësore të datës 13.04.2022, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi:
- (i) shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, pasi çmoi se vendimi nr. 506, datë 31.01.2022, i Komisionit është bazuar në shkelje të rënda procedurale dhe në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht e në mënyrë jo të plotë;
  - (ii) përcjelljen nga Komisioni të akteve procedurale me të cilat ka kryer komunikimin me subjektin e rivlerësimit në kuadër të vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Bica.
16. Në zbatim të vendimit të mësipërm të trupit gjykues, seanca gjyqësore publike e datës 12.05.2022, u zhvillua në prani të subjektit të rivlerësimit dhe avokatit të tij Klodjan Skënderaj, të cilët parashtruan shkaqet e ankimit, si dhe pretendimet e tyre lidhur me vendimin nr. 506, datë 31.01.2022, të Komisionit.
- Në seancë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit, për të mbështetur pretendimet e parashtruara prej tij në ankim, kërkoi që aktet e paraqitura së bashku me ankimin të merreshin në cilësinë e provës. Në funksion të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45, 49, 50 dhe 65 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të pranojë marrjen në cilësinë e provës të disa prej akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, të KLP-së "Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror, të z. Petrit Bica" dhe kërkesën nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021, "Për miratimin e pensionit të parakohshëm", drejtuar KLP-së, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se këto akte gjenden në dosjen e procesit të rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, për pasojë vlerësoi se është e panevojshme të administrohen si provë, në kuadër të parashikimit të nenit 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket aktit "Vendim nr. {\*\*\*}, datë 15.10.2020, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për mbarimin e statusit të magjistratit", paraqitur dhe kërkuar nga subjekti i rivlerësimit të merret në cilësinë e provës në seancë gjyqësore, trupi gjykues vlerësoi të mos administrohet si provë, në kuadër të parashikimit

të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, pasi marrja e tij ishte e panevojshme për shkak se fakti që kërkohej të provohej ishte i parëndësishëm për gjykimin.

Trupi gjykues vendosi të administrojë në cilësinë e provës edhe aktet e përcjella nga Komisioni me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.04.2022 dhe regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.04.2022, në funksion të vendimit të ndërmjetëm në seancën gjyqësore të datës 13.04.2022, lidhur me komunikimet e Komisionit me subjektin e rivlerësimit në kuadër të vendimit nr. 506, datë 31 janar 2022, për ndërprejen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit dhe të bëra të njohura edhe këtij të fundit.

17. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi ligjor i tij, avokat Klodjan Skënderaj, kërkuan përfundimisht pranimin e ankimit.

*B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit*

18. Lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit *Komisioni abuzon, paraqet të dhëna të rreme, nuk është objektiv në raport me të vërtetën dhe aktet e administruara*, trupi gjykues konstaton si më poshtë.
19. Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, subjekti i rivlerësimit ka parashtuar se pjesa arsyetuese e vendimit, si dhe dispozitivi është marrë *copy paste* nga një vendim tjetër i Komisionit, pikërisht nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 10.12.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit B. M., i cili përbën një rast ku KLP-ja ka marrë një vendimmarrje krejt tjetër dhe, për pasojë, ky fakt përbën një penalizim të paligjshëm, të padrejtë dhe të pabazuar në prova për subjektin e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se më datë 01.02.2022, në faqen e internetit të Komisionit, në rubrikën “Vendime”, ka lexuar dhe printuar vendimin nr. 506, datë 31.01.2022, në të cilin, në faqen 2, paragrafi 7, citohej: *7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.1.2022, mbështetur në germën “a” të pikës 1 të nenit 64 dhe në nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, vendosi: “(1) Deklarimin e mbarimit të statusit, për shkak dorëheqjeje, të magjistratit B. M., aktualisht prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. (2) Dorëheqja jep efektet në datën 31.1.2022. Ky vendim i është përcjellë subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”*. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi nr. 506, datë 31.01.2022, me përmbajtjen si më sipërcituar, po në të njëjtën datë, pas disa orësh, është fshirë dhe është zëvendësuar me një vendim tjetër, në të cilin është ndryshuar vetëm emri nga “B. M.” në “Petrit Bica”.
20. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës: vendimin nr. 506, datë 31.01.2022, të Komisionit, të panëshkruar nga trupi gjykues i Komisionit, i cili në faqen 2, paragrafi 7, mban emrin B. M., si dhe vendimin nr. 506, datë 31.01.2022, të Komisionit, i panëshkruar nga trupi gjykues i Komisionit, i cili në faqen 2, paragrafi 7, mban emrin Petrit Bica. Në vlerësimin e trupit gjykues, aktet e sipërcituara nuk provojnë në asnjë rast se:
  - (i) janë akte autentike të Komisionit;

- (ii) janë akte të publikuara në faqen zyrtare në internet të Komisionit, e aq më tepër të jenë publikuar në të njëjtën datë.

Nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të publikuar në faqen zyrtare në internet të Komisionit, me datë publikimi 31.01.2022, dhe përmbajtjes së vendimit që gjendet në dosjen e rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, për efekt të shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit, i cili i është njoftuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet shërbimit postar e është pranuar prej tij si i tillë në ankim, trupi gjykues konstaton se përmbajtja e tyre është e njëjtë.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka publikuar dy herë vendimin, duke korrigjuar të dhënat në të, mbetet i pabazuar në prova.

21. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit në funksion të të njëjtit shkak ankimi, se Komisioni, në pikën 7, faqe 2 e vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, citon se KLP-ja, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit, për shkak dorëheqjeje, të magjistratit Petrit Bica, aktualisht prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kur në fakt, në kërkesën e drejtuar KLP-së nga subjekti i rivlerësimit, provat e paraqitura përpara KLP-së, si dhe në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, të KLP-së, nuk përmendet apo evidentohet në ndonjë rast “dorëheqja”, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues vëren se ky i fundit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.12.2021, i ka kërkuar KLP-së informacion nëse është marrë vendim nga ky institucion në lidhje me kërkesën nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021, “Për miratimin e pensionit të parakohshëm”, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Petrit Bica, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. KLP-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.01.2022, i ka përcjellë Komisionit vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror, z. Petrit Bica”. Referuar këtij vendimi, KLP-ja, bazuar, ndër të tjera, në nenin 27, pikat 1, 1/2 dhe 3, në nenin 64, pika 1, shkronja “c” dhe pika 5 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), si dhe në kërkesën e paraqitur nga z. Petrit Bica, ka vendosur:

1. *Miratimin e pensionit të parakohshëm për z. Petrit Bica, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.*

2. *Mbarimin e statusit të magjistratit të prokurorit Petrit Bica, më datë 31.01.2022 [...].*

Në kërkesën “Për miratimin e pensionit të parakohshëm”, të datës 01.12.2021, drejtuar KLP-së, regjistruar me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021<sup>5</sup>, subjekti i rivlerësimit është shprehur: [...] *kërkoj mirëkuptimin tuaj [...], duke pranuar kërkesën për miratimin e pensionit të parakohshëm. Kjo kërkesë gjen mbështetje në nenin 27, pika 1, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016, si dhe në nenin 6, pika 2 (1/2) e ligjit nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”.*

---

<sup>5</sup> Bashkëlidhur kërkesës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dhe dokumentacionin e nevojshëm që vërteton plotësimin e kushteve ligjore për daljen në pension të parakohshëm pleqërie, si dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.11.2021, “Dhënie mendimi për miratimin e pensionit të parakohshëm për prokurorin, z. Petrit H. Bica”, të nënshkruar nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.



22. Trupi gjykues konstaton se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në kërkesën e tij drejtuar KLP-së, si më sipërcituar, nuk kërkohet dorëheqja sipas nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar dhe se referimi i Komisionit në pikën 7, në faqen 2 të vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, nuk përputhet me përmbajtjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, të KLP-së “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror, z. Petrit Bica”, pasi në preambulën e këtij të fundit nuk rezulton të jetë referuar neni 65 i ligjit nr. 96/2016. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se situata faktike është konstatuar gabimisht nga Komisioni, për pasojë, në zbatim të kompetencave korrigjuese lidhur me gabimet procedurale të kryera nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, parashikuar shprehimisht në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, duke i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në mënyrë efektive përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, lidhur me të gjitha pretendimet e tij mbi procesin e rivlerësimit.
23. Lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit *arsyetimi dhe dispozitivi i Komisionit, bazuar në parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është i papranueshëm dhe joligjor, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kërkesë për dorëheqje përpara KLP-së, por ka ushtruar të drejtën për të dalë në pension, në bazë të nenit 52 të Kushtetutës, ka respektuar të drejtën e pakufizuar të njohur nga ligji për të dalë në pension të parakohshëm, për rrjedhojë vendimi i Komisionit ka shkelur parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, ka bërë që subjekti i rivlerësimit të penalizohet pa ligj, në shkelje të parimit universal të ligjshmërisë, duke rënë ndesh me Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, trupi gjykues konstaton si vijon.
24. Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: *Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit Petrit Bica ka shprehur vullnetin për të mos vijuar ushtrimin e detyrës, pavarësisht se ende nuk ka mbushur moshën 67 vjeç, kohë kur mbarimi i statusit për shkak të moshës, deklarohet nga KLP-ja. Shprehja e vullnetit të subjektit për të ndërprerë marrëdhëniet e tij të punës, bërja prezent para Komisionit e këtij fakti dhe formalizimi me paraqitjen e kërkesës drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, çmohen nga trupi gjykues si ndërprerje për shkak të vullnetit të subjektit për të lënë detyrën përpara kohe, duke e konsideruar këtë si dorëheqje të tij. Për sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, me veprime konkrete, ka hequr dorë nga ushtrimi i detyrës së prokurorit, ndërkohë që ende nuk ka mbushur moshën 67 vjeç të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, trupi gjykues vlerëson se për sa subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij, ka lënë detyrën që ushtronte përkundrejt mundësisë ligjore për të vazhduar ushtrimin e funksionit, situata faktike kualifikohet sipas parashikimeve të germës “a” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, dorëheqjes nga detyra. Mbarimi i statusit të magjistratit, parashikuar nga germa “a” e pikës 1 të nenit 64 dhe neni 65 i ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet vetëm me ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të pashmangshme edhe me procesin e rivlerësimit në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë edhe humbjen e*

*statusit si subjekt rivlerësimi ex officio dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, parashikojnë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke zbatuar në këtë rast nenin G të Aneksit të Kushtetutës, që parashikon ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. [...] Refuzimi i subjektit të rivlerësimit për të vijuar ushtrimin e detyrës së prokurorit deri në moshën 67 vjeç, konsiderohet dorëheqje nga detyra e prokurorit/statusi i magjistratit në kuptim germës "a" të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, që sjell si pasojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e ndalimit të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.*

Në përfundim, Komisioni ka vendosur: 1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petrit Bica, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 2. Ndalimin e emërimit të z. Petrit Bica si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare [...].

25. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të arsytimit dhe dispozitivit të vendimit të Komisionit si më sipërcituar, ka argumentuar, si vijon.

25.1 Në arsyetimin e vendimit të Komisionit, parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës nuk mund të zbatohen, duke qenë se mungon dorëheqja para këshillit përkatës, e cila duhet të jetë me shkrim dhe në referencë të ligjit, pasi kjo dispozitë është e lidhur vetëm me dorëheqjen. Arsyetimi i Komisionit është i papranueshëm dhe joligjor, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kërkesë për dorëheqje përpara KLP-së, por ka ushtruar të drejtën për të dalë në pension, në bazë të nenit 52 të Kushtetutës, ka respektuar të drejtën e pakufizuar të njohur nga ligji për të dalë në pension të parakohshëm, i cili është pension pleqërie i reduktuar, që nuk mund ta kufizojë as arsyetimi i gabuar dhe jokorrekt e joligjor i Komisionit. Për këtë arsye, vendimi i Komisionit ka shkelur parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative. Mungesa e bërjes së aktit të dorëheqjes nga subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 64, pika 1, shkronja "a" dhe neni 65 të ligjit nr. 96/2016, ka bërë që ai të penalizohet pa ligj nga vendimi i Komisionit, në shkelje të parimit universal të ligjshmërisë e, për pasojë, dispozitivi i vendimit bie ndesh me Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

25.2 Daljen në pension dhe mbarimin e statusit për subjektin e rivlerësimit e ka vendosur organi kompetent i ngarkuar me ligj, siç është KLP-ja. Pas marrjes së vendimit nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, të KLP-së, subjekti i rivlerësimit nuk gëzonte më statusin e magjistratit dhe, për pasojë, nuk është më subjekt i ligjit nr. 84/2016. Ndërprerja e funksionit për shkak të daljes në pension nuk mund të barazohet me dorëheqjen, pasi janë dy koncepte krejtësisht të ndryshme.

25.3 Parashikimi i pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës është i lidhur me vullnetin dhe qëndrimin subjektiv të magjistratit për t'u larguar nga detyra dhe jo me shkaqe objektive, sikurse është rasti i subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka shprehur vullnetin e tij dhe ka dalë në pension sipas Kushtetutës për shkaqe objektive dhe ligjore, të parashikuara shprehimisht nga neni 6, pikat 2 dhe 1/2, si dhe neni 27, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Komisioni nuk ka mbajtur parasysh se “dalja në pension” dhe “dorëheqja” janë dy institute që nuk mund të qëndrojnë njëherazi, pasi përjashtojnë njëri-tjetrin. Të dyja këto institute sjellin ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, por ato ndryshojnë katërcipërisht me njëra-tjetrën, pasi dalja në pension është e lidhur domosdoshmërisht me moshën – magjistrati duhet të ketë mbushur moshën 60 vjeç dhe të ketë të paktën 30 vjet në ushtrim të funksionit si magjistrat – kushte që subjekti i plotëson; ndërsa dorëheqja shpreh vetëm një vullnet subjektiv dhe të pakushtëzuar të individit, kur ende ekzistojnë marrëdhëniet e punës së magjistratit.

26. Në analizë të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi në raport me legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vëren se ligji nr. 96/2016, i ndryshuar, i cili përbën dhe kuadrin ligjor që përcakton moshën dhe kushtet e daljes në pension të parakohshëm të magjistratëve, në nenin 27, “Pensioni i parakohshëm”, pika 1<sup>6</sup> parashikon:

*1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:*

*a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç;*

*b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit;*

*1/1 Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm edhe në rast se Këshilli vendos mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të pamundësisë fizike dhe mendore sipas nenit 67 të këtij ligji.*

*1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë më del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 64 të këtij ligji, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë për magjistratët që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni, është 0,6 për qind në muaj [...].*

I njëjti ligj, në nenin 64, “Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit”, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”<sup>7</sup> dhe pika 5, parashikon:

*1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:*

*a) jep dorëheqjen; [...]*

*c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji [...].*

*5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë*

<sup>6</sup> Përmbajtja e kësaj pike është ndryshuar me ligjin nr. 50/2021, datë 23.03.2021.

<sup>7</sup> Përmbajtja e shkronjës “c” dhe pikës 5 janë ndryshuar me ligjin nr. 48/2019 dhe ligjin nr. 50/2021.

*se 6 muaj përpara plotësimin të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaroi me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.*

27. Në çështjen objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit ka shprehur vullnetin për të mos vazhduar ushtrimin e detyrës deri në mbushjen e moshës 67 vjeç, rast në të cilin, sipas përcaktimit ligjor të sipërcituar, mbarimi i statusit të magjistratit do të deklarohet nga KLP-ja për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

Vullnetin për të mos vazhduar ushtrimin e detyrës së prokurorit deri në mbushjen e moshës 67 vjeç, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në kërkesën “Për miratimin e pensionit të parakohshëm”, të datës 01.12.2021, drejtuar KLP-së nga subjekti i rivlerësimit dhe regjistruar në këtë institucion me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021, në të cilën është shprehur: *Kam pasur nderin dhe privilegjin që për një kohë prej 30 vjet e 10 muaj të punoj në detyrën e prokurorit [...]. Duke qenë se jam në një moshë relativisht të madhe dhe konkretisht deri në datën 01.12.2021 që po bëj kërkesën, jam 63 vjeç e 6 muaj e 20 ditë, për shkak të ngarkesës së madhe e të papërbalueshme nga ana ime në punë, si dhe problemeve shëndetësore që po përballem aktualisht, pasi jam i sëmurë dhe kurohem për tension, zemër, diabet, kërkoj mirëkuptimin tuaj [...], duke pranuar kërkesën për miratimin e pensionit të parakohshëm, si dhe në kërkesën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.11.2021, për “Dhënie mendimi për miratimin e pensionit të parakohshëm për prokurorin, z. Petrit H. Bica”, drejtuar drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën, përveç sa është cituar më sipër, subjekti i rivlerësimit është shprehur: [...] duke u ndjerë në pamundësi shëndetësore për të ushtruar me efikasitet detyrën e prokurorit, si dhe duke vlerësuar se kërkesa ime është e bazuar në ligj, mbetem me shpresë se do të jepet mendimi pozitiv nga ana juaj.*

Këto akte, subjekti i rivlerësimit ia ka vënë në dispozicion Komisionit, nëpërmjet postës elektronike, me e-mail-in e datës 02.12.2021. Në vijim, Komisioni, me e-mail-in e datës 23.12.2021, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shprehjen e vullnetit të pavesuar për vijimin ose jo të procesit të rivlerësimit, pasi nëse ai do të konfirmonte vijimin e këtij procesi, Komisioni do t'i dërgonte rezultatet e hetimit administrativ. Me e-mail-in e datës 19.01.2022, subjekti i rivlerësimit i ka konfirmuar Komisionit se nuk do të ankimonte vendimin e KLP-së nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022, i cili kishte miratuar pensionin e parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit<sup>8</sup>. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij, ka lënë detyrën që ushtronte përkundërt mundësisë/parashikimit ligjor për të vazhduar ushtrimin e funksionit, pasi me veprime konkrete, ka hequr dorë nga ushtrimi i tij, ndërkohë që ende nuk kishte mbushur moshën 67 vjeç, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, për të dalë në pension të plotë pleqërie dhe të vazhdonte të ushtronte detyrën e të gëzonte statusin e magjistratit edhe për disa vjet të tjerë, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtet për të kualifikuar këtë situatë faktike sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

---

<sup>8</sup> Gjatë gjyqimit në Kolegj, nuk rezultoi e provuar që subjekti i rivlerësimit të ketë ushtruar ankim ndaj vendimit të KLP-së nr. {\*\*\*}, datë 14.01.2022.

28. Trupi gjykues pajtohet me subjektin e rivlerësimit se “dalja në pension të parakohshëm pleqërie” nuk është e njëjtë me “dorëheqjen nga detyra”, por vlerëson se mbarimi i statusit të magjistratit për shkak të daljes në pension pleqërie, parashikuar nga neni 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet vetëm me ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por në të njëjtën kohë e në mënyrë të pashmangshme afekton dhe procesin e rivlerësimit në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.
29. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka shprehur vullnetin për të dalë në pension për shkaqe objektive dhe ligjore, të parashikuara shprehimisht nga neni 27 i ligjit nr. 96/2016 dhe jo për shkaqe subjektive sipas parashikimit të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret, shkakun subjektiv dhe ai objektiv i largimit nga detyra janë të ndërlidhur, pasi sipas parashikimit ligjor të nenit 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të vazhdonte të ushtronte detyrën deri në moshën e parashikuar nga ligji për të dalë në pension të plotë pleqërie. Në momentin që subjekti i rivlerësimit ka shprehur qëndrimin e tij subjektiv për të lënë me vullnet të lirë detyrën e prokurorit dhe për të mbaruar statusin e magjistratit që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë në konsideratë edhe pasojën ligjore në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Kjo pasojë ligjore e rrjedhur për shkak të daljes në pension të parakohshëm, i është bërë e ditur subjektit të rivlerësimit nga Komisioni, nëpërmjet komunikimit me postë elektronike, me *e-mail*-in e datës 17.01.2022, dhe subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen drejtuar Komisionit me *e-mail*-in e datës 23.01.2022, ka konfirmuar vullnetin e tij të lirë e të pavesuar për mbarimin e statusit të magjistratit<sup>9</sup>.
30. Subjekti i rivlerësimit ka gëzuar statusin e magjistratit prokuror dhe, për pasojë, të gjitha përfitimet që rrjedhin prej tij, duke fituar dhe të drejtën për të qëndruar në detyrë deri në mbushjen e moshës për të dalë në pension pleqërie 67 vjeç. Ushtrimi i kësaj të drejte shoqërohet në të njëjtën kohë me mbajtjen e statusit të magjistratit dhe me detyrimin për t’u nënshtruar procesit të rivlerësimit. Nëse kjo e drejtë nuk ushtrohet nga subjekti i rivlerësimit, qoftë edhe për shkak të daljes në pension të parakohshëm, bazuar në zgjedhjen e tij sipas parashikimit të nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, sjell si pasojë ligjore ndalimin sipas parashikimit të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
- Bazuar në sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se arsyetimi dhe dispozitivi i Komisionit, bazuar në parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është në shkelje të parimit të ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, duke rënë ndesh

---

<sup>9</sup> Siç rezulton nga aktet e përcjella nga Komisioni në Kolegj me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.04.2022, dhe regjistruar në këtë të fundit me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.04.2022, akte të administruara nga trupi gjykues në seancën gjyqësore të datës 12.05.2022.

me Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjendet i pabazuar.

31. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni dhe gjatë gjykimit në Kolegj, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 506, datë 31.01.2022, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Bica dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit objekt shqyrtimi, është marrë në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 506, datë 31.01.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Bica.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 16.05.2022, në Tiranë.

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi – kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se jemi në kushtet e ndryshimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 506, datë 31.1.2022 (në vijim “KPK”), që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Bica (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në lidhje me pikën 2 të dispozitivit të vendimit që përcakton ndalimin e emërimit të z. Petrit Bica si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Arsyet se përse vlerësoj që ky vendim duhej të ndryshohej, po i parashtroj në këtë mendim pakice.
2. KPK-ja, me vendimin nr. 506, datë 31.1.2022, ka vendosur:
  1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petrit Bica, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
  2. Ndalimin e emërimit të z. Petrit Bica si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare [...].
3. KPK-ja e ka bazuar vendimmarrjen e mësipërme në këtë bazë kushtetuese dhe ligjore: (i) në nenin G të Aneksit të Kushtetutës; (ii) në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016; dhe (iii) në nenet 64 e 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”).
4. Subjekti i rivlerësimit, në ankim ka kërkuar ndryshimin, saktësimin e pjesës arsyetuese dhe ndryshimin e dispozitivit të vendimit nr. 506, datë 31.1.2022, të KPK-së: *Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Petrit Bica, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura, është bërë i pamundur.*
5. Nuk ndaj mendim të njëjtë me shumicën e trupit gjykues që votuan për lënien në fuqi të vendimit të KPK-së, për sa i përket interpretimit që u është bërë shkaqeve objektive dhe subjektive të largimit nga detyra, të ndërlidhura me procesin e rivlerësimit, sipas paragrafit 29 të vendimit të Kolegjit, ku arsyetohet se: [...] *Trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret, shkakun subjektiv dhe ai objektiv i largimit nga detyra janë të ndërlidhur, pasi sipas parashikimit ligjor të nenit 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të vazhdonte të ushtronte detyrën deri në moshën e parashikuar nga ligji për të dalë në pension të plotë pleqërie. Në momentin që subjekti i rivlerësimit ka shprehur qëndrimin e tij subjektiv për të lënë me vullnet të lirë detyrën e prokurorit dhe për të mbaruar statusin e magjistratit që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit ex officio, duhet të marrë në konsideratë edhe pasojën ligjore në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*
6. KPK-ja, në arsyetimin e vendimit, në paragrafët nr. 14 e 15, ka parashtruar se: *Shprehja e vullnetit të subjektit për të ndërprerë marrëdhëniet e tij të punës, bërja prezent para Komisionit e këtij fakti dhe formalizimi me paraqitjen e kërkesës drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, çmohen nga trupi gjykues si ndërprerje për shkak të vullnetit të subjektit për të lënë detyrën përpara kohe, duke e konsideruar këtë si dorëheqje të tij. Për sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, me veprime konkrete, ka hequr dorë nga ushtrimi i detyrës së prokurorit, ndërkohë që ende nuk ka mbushur moshën 67 vjeç, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, trupi gjykues vlerëson se për sa*

*subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij, ka lënë detyrën që ushtronte përkundrejt mundësisë ligjore për të vazhduar ushtrimin e funksionit, situata faktike kualifikohet sipas parashikimeve të germës “a” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, dorëheqjes nga detyra.*

7. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, ashtu si u trajtua edhe gjatë gjykimit në seancë publike, vlerësoj se u konstatua qartë fakti që subjekti, bazuar në nenin 27, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016<sup>10</sup>, ndryshuar me ligjin nr. 50/2021, kishte paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”), kërkesën për miratimin e pensionit të parakohshëm<sup>11</sup>, mbi bazën e së cilës ky organ, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.1.2022, vendosi miratimin e pensionit të parakohshëm për z. Petrit Bica, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe mbarimin e statusit të magjistratit më datë 31.1.2022.
8. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kërkesës drejtuar KLP-së, ka kërkuar zbatimin e së drejtës për të dalë në pension të parakohshëm, të drejtë që e garanton ligji i posaçëm, i cili përcakton edhe se pensioni i parakohshëm nuk është gjë tjetër, veçse një pension pleqërie i reduktuar që objektivisht sjell pengesën ligjore për të ushtruar detyrën e prokurorit/magjistratit, fakt i cili lidhet në mënyrë të pashmangshme me kushtin bazë, mbarimin e statusit të magjistratit, siç edhe është konstatuar me vendimin e KLP-së. Në përmbushje të këtij parashikimi ligjor, miratimi i kërkesës për pension të parakohshëm sipas nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, ndryshuar me ligjin nr. 50/2021, kërkon plotësimin e disa kushteve, mospërmbushja e të cilave çon automatikisht në refuzimin e kërkesës nga ana e KLP-së, duke bërë të pamundur që magjistrati *ta gëzojë të drejtën* e pensionit të parakohshëm sipas këtij neni dhe mbarimin e statusit të magjistratit, sipas nenit 64, pika 1 shkronja “c” e po këtij ligji, të ndryshuar<sup>12</sup>.
9. Në ndryshim nga kërkesa për pension të parakohshëm, kërkesa për dorëheqje, sipas nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 96/2016<sup>13</sup>, është një e drejtë që e parashikon ligji, por që ushtrohet mbi bazë vullneti

<sup>10</sup> Neni 27 i ligjit nr. 96/2016, ndryshuar me ligjin nr. 50/2021, parashikon se:

“Pensioni i parakohshëm:

1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:

a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç;

b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit.

1/1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm edhe në rast se Këshilli vendos mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të pamundësisë fizike dhe mendore sipas nenit 67 të këtij ligji.

1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë në qe del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 64 të këtij ligji, me koeficientin mujor të reduktimit. [...].

2. [...]

3. Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës/prokurorisë.

4. [...].”

<sup>11</sup> Kërkesa me nr. {\*\*\*} prot., datë 01.12.2021, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë

<sup>12</sup> Neni 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, ndryshuar me ligjin nr. 50/2021 parashikon se:

“1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji;

d) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;

d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën”.

<sup>13</sup> Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, parashikon se:

“Dorëheqja:

1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.



të brendshëm të magjistratit dhe që vetë ligji e parashikon me *mund*, madje për ushtrimin e dorëheqjes nuk kërkohet *as që ajo të jetë e arsyetuar*.

10. Për sa më lart, në vlerësimin tim, instituti i “dorëheqjes” dhe instituti i “daljes në pension”, si të drejta të magjistratit që rregullohen me baza ligjore të ndryshme dhe passjellin pasoja personale e financiare të ndryshme, nuk mund të aplikohen për analogji të njëri-tjetrit, në funksion të vijimit apo ndërprerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Të dyja këto institute sjellin ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, por dallojnë qartësisht njëri nga tjetri sepse “dalja në pension të parakohshëm” është e lidhur domosdoshmërisht me dy kushte ligjore: me moshën, ku magjistrati duhet të ketë mbushur moshën 60 vjeç, dhe me ushtrimin e funksionit të magjistratit për të paktën 30 vjet, kushte të cilat, nga shqyrtimi i akteve në fashikull, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit i plotëson. Ndërsa “dorëheqja”, si shprehje vetëm e vullnetit subjektiv të magjistratit, kur ende ekzistojnë marrëdhëniet e punës, rezultojnë të mos jetë e kushtëzuar me kërkesa të posaçme ligjore. Këto dy institute, në rastin kur nuk janë të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë apo në ligj, nuk mund ta zëvendësojnë njëri-tjetrin.
11. Leximi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës<sup>14</sup> dhe aplikimi si bazë ligjore e “dorëheqjes” në rastet e “daljes në pension”, kur kjo nuk është e përcaktuar qartësisht nga ligjvënësi, përveç cenimit të parimit të ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, duke bërë që subjekti i rivlerësimit të penalizohet pa ligj, vjen ndesh me Kushtetutën, me ligjet në fuqi, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
12. Një arsye tjetër që vendimi i KPK-së duhej të ndryshohej nga trupi gjykues i Kolegjit, është edhe fakti se vendimi nr. 506, datë 31.1.2022, është marrë në ditën kur për subjektin e rivlerësimit, statusi i magjistratit kishte përfunduar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.1.2022, të KLP-së. Kjo do të thotë se më datë 31.01.2022, sipas vendimmarrjes së KLP-së, subjekti i rivlerësimit nuk e gëzonte më *de jure* dhe *de facto* statusin e magjistratit, ishin ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe financiare me organin e prokurorisë, duke bërë që subjekti të mos ushtronte më funksionin e prokurorit/magjistratit. Në këtë aspekt, vetë vendimi i KPK-së ka mbetur pa objekt.
13. KPK-ja, në vendimin e saj, konfirmuar nga trupi gjykues i Kolegjit në paragrafin 31 të vendimit, ka përcaktuar si bazë ligjore të aplikueshme në këtë rast, nenin G të Aneksit të Kushtetutës, nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 64 e 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Vlerësoj se kjo është një bazë ligjore e gabuar, pasi bazohet në “dorëheqjen” dhe nuk bazohet në “daljen në pension të parakohshëm”, sipas nenit 27 të po këtij ligji, që do të çonte në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, për shkak se objekti për të cilin ka filluar ky proces, nuk është më i mundur.
14. Edhe sikur të pranohej teorikisht fakti që subjekti mund të pretendojë në një moment të mëvonshëm fitimin përsëri të statusit të magjistratit, duke aplikuar për një pozicion të tillë tek organet e emërtesës, ky kërkim do ta penalizonte subjektin me cenim të etikës dhe figurës së

---

2. *Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.*

3. [...].”

<sup>14</sup> *Neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Dorëheqja: 1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

magjistratit, duke iu referuar situatës juridike të kërkesës së tij për përfitimin e pensionit të parakohshëm, rrethanë kjo që do të vlerësohej domosdoshmërisht nga këto organe. Për sa kohë një situatë e tillë mbetet hipotetike, nuk ka vend për analogji dhe paralelizëm të situatave të ndryshme faktike që rregullohen me norma të ndryshme ligjore, ashtu si arsyeton shumica në vendimin e saj.

15. Referuar arsyetimit të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit duhej ta kishte ndryshuar vendimin nr. 506, datë 31.01.2022, të KPK-së dhe, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.1.2022, të KLP-së, të vendoste për të deklaruar të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Petrit Bica, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.

**GJYQTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*